


Zhvillimi i shkathtësive jetësore

Siç ishte prezantuar në kursin mbi *Zhvillimin shumëdimensional të pjesëmarrësve*, sporti për zhvillim është më shumë se ‘vetëm’ ushtrim fizik dhe trajnim për shkathtësi. Në kombinim me zhvillimin gjithëpërfshirës të pjesëmarrësve (të rinjve), qëllimi është që të **promovohen dhe zhvillohen shkathtësitë jetësore**. Ky kurs për Zhvillimin e shkathtësive jetësore hulumton më për së afërmi se çfarë shkathtësish mund të mësohen dhe si. Si gjithmonë, mbajeni në mend se ekzistojnë pesë parime kryesore dhe se S4D mund ta zhvillojë potencialin e vetë të plotë vetëm nëse merren parasysh dhe aplikohen të gjitha parimet.




! **'Kompetenca'** mund të përdoret si sinonim për **'shkathtësi jetësore'**.

Shkathtësitë jetësore janë thelbësore për t'u ndihmuar pjesëmarrësve (të rinjve) që t'i **tejkalojnë sfidat brenda dhe jashtë fushës së trajnimit** dhe të sigurojnë që ata ta jetojnë një jetë të suksesshme dhe të përmbushur. Të gjitha shkathtësitë jetësore të cekura në këtë kurs mund të mos mësohen në secilin vend ose projekt. Në vend të kësaj, ato paraqesin tërësinë e shkathtësive jetësore që mund të mësohen duke përdorur S4D.

Sporti është veten një instrument i dobishëm për mësimin e shkathtësive jetësore sepse **pjesëmarrësit e rinj mund të jenë cak i lehtë dhe mund të përfshihen në mënyrë aktive nëpërmjet sportit**. Shkathtësitë jetësore duhet të integrohen në një sesion të zakonshëm trajnimi, duke e bërë bartjen e tyre më delikate dhe përmbajtësore, sesa kur mësohen duke përdorë metodat tradicionale të mësimdhënies. Në atë mënyrë, fëmijët dhe të rinjtë mund t'i përjetojnë shkathtësitë drejtpërdrejtë dhe do të jenë në gjendje t'i integrojnë ato më lehtë. Ekzistojnë **tri grupe kryesoretë kompetencave: kompetencat personale, sociale dhe metodologjike**. Secili grup përbëhet nga një numër i shkathtësive specifike, individuale jetësore që mund të zhvillohen duke e përdorë sportin si mjet. Lista e plotë e këtyre shkathtësive jetësore është paraqitur më poshtë. Grupet themelore dhe të detajuara të kompetencave për fëmijë dhe të rinj mund të gjenden në ueb-faqen 'Sport for Development Resource Toolkit' nën: [Essentials – S4D Competences – Children and Youth Competences](#). Mirëpo, edhe pse bazike dhe e detajuar, Korniza e Kompetencave e Fëmijëve dhe të Rinjve në Sportin për Zhvillim prapëseprapë mund të duket mjaft e gjerë dhe e pa-definuar. Prandaj është absolutisht me rëndësi që **shkathtësitë individuale të secilit grup gjithmonë t'i përshtaten kontekstit specifik dhe temës së sesionit të trajnimit të S4D** siç janë Sporti për Shëndet, Sporti për Barazi Gjinore, Sporti për Parandalimin e Dhunës ose Sporti për Punësim.

Qëllimi i S4D është që t'i **integrojë shkathtësitë jetësore në sesionet e trajnimit** në një mënyrë që u mundëson pjesëmarrësve të rinjtë t'i integrojnë ato dhe t'i bartin në kontekstin e jetës së tyre të përditshme. Një gamë e gjerë e shkathtësive mund të mësohen duke e përdorë sportin si mjet për zhvillimin e tyre. Këtu përfshihen:




Vetë-perceptimi	Besimi	Motivimi	Përgjegjësia	Qëndrueshmëria	Disiplina	Zgjidhja e konflikteve
Orientimi drejt qëllimit	Përshtatshmëria	Kreativiteti	Empatia	Solidariteti	Bashkëpunimi	Respekti & Toleranca
	Loja e ndershme & Barazia	Komunikimi	Të menduarit kritik	Shkathtësitë vendim-marrëse	Zgjidhja e problemeve	

Në mënyrë që pjesëmarrësit (të rinjtë) të jenë në gjendje t'i zhvillojnë shkathtësitë jetësore duke i përdorë aktivitetet e S4D, është me rëndësi që të jemi të njoftuar me procesin që ndodh kur i zhvillojmë këto shkathtësi. Kompetenca të ndryshme personale, sociale dhe metodologjike duhet të zhvillohen në mënyrë të përsëritur dhe të vazhdueshme, në mënyrë që pjesëmarrësit t'i integrojnë ato me kalimin e kohës dhe të jenë në gjendje të lëvizin nga jo-kompetenca e pavetëdijshme në kompetenca reflektive.

Siç u cek më herët, kornizat e kompetencave duhet t'u përshtaten temave dhe konteksteve specifike. Një shembull i dobishëm se si mund të duket një temë specifike e grupit të kompetencave mund të gjendet në ueb-faqen *Sport for Development Resource Toolkit* nën: [Topic Collection – Sport for Employability – Competences – Competences Children and Youth](#).

Disa shembuj të përzgjedhur të shkathtësive të detajuara, themelore jetësore të S4D (krahasuar me shkathtësitë jetësore të temave specifike) që mësohen në sesionin e trajnimit Sport për Punësim janë përfshirë në tabelën më poshtë. Këta shembuj janë vetëm një mostër përfaqësuese dhe, në asnjë mënyrë, nuk e ofrojnë një pasqyrë të plotë. Kornizat e plota të kompetencave mund të gjenden nën linkun që është cekur më lartë.



		Shkathtësitë jetësore që i fitojnë fëmijët dhe të rinjtë në S4D	Shkathtësitë jetësore që i fitojnë fëmijët dhe të rinjtë në Sporti për Punësim
Kompetencat personale	Vetëbesimi dhe Besimi	... të dinë për aftësitë dhe kualifikimet e tyre	... të jenë të sigurt dhe të besojnë në aftësitë dhe kualifikimet e tyre për të marrë vendime (të guximshme) (p.sh. të aplikojnë për një vend pune)
	Kompetencat sociale	Respekti, Loja e ndershme dhe Toleranca	... të jenë të respektueshëm dhe tolerantë ndaj kolegëve ose shokëve të rinj të ekipit që vijnë nga mjedise ose kontekst tjetër
		Vendim-marrja	... ta vlerësojnë një situatë të caktuar dhe ta zgjedhin mënyrën e përshtatshme të veprimit